



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:046396
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05698976

AA.nr.648/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, S.C, Komuna e Podujevës, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe viktimave civile, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, përkitazi me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje administrative, A.nr.390/2023, të datës;03.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.05.2024, merr këtë,

A K T V E N D I M

Miratohet si e bazuar ankesa e paditësit, S.C, Komuna e Podujevës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.390/2023, i datës;03.07.2023, priset dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.390/2023, të datës;03.07.2023, është vendosur, *“I. REFUZHET kërkesa e paditësit e datës 19.06.2023 për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore për padi. II. KONSIDEROHET se është tërhequr padia e paditësit S.C, Komuna e Podujevës, nën shenjën A.nr.390/2023 i dt.22.02.2323, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore për padi.”*

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që të aprovet ankesa e paditësit, ndërsa aktvendimi i ankimuar të priset, dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

Përgjigje në ankesë nuk kanë paraqitur pala e paditur.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë:31.11.2022, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe viktimave civile, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, sepse konsideron se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa bazë dhe jo i ligjshëm, për arsye se nuk është vlerësuar drejtë gjendja faktike nga ana e organeve administrative, si dhe është zbatuar gabimisht edhe ligji material, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të paditurës, bie aktvendimin e ankimuar me të cilin refuzon kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore, po ashtu me të njëjtin aktvendim padinë e paditësit e konsideron të tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës për padi, me arsyetim se *“Gjykata me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjeti se padia e paditësit nuk përmban dëshmi se i njëjti ka paguar taksën gjyqësore për padi. Gjykata me datë 18.05.2023, paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vërejtjes, të bëjë pagesën në shumën prej 50€, dhe dëshminë e fletëpagesës t’ia dorëzoj gjykatës, nën kërcënimin e pasojave juridike në rast të mosveprimit sipas udhëzimeve të gjykatës. Paditësi ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore me dt.05.06.2023, mirëpo taksën nuk e ka paguar, në vend të kësaj ka dorëzuar parashtresë me dt.19.06.2023, me kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore me të cilën e ka njoftuar gjykatën se pasi që unë jam kategori e dal nga lufta dhe këtë e dëshmoj me dokumente dhe vërtetimin me nr.173/2017 të lëshuar nga zyra për qështje te kategorive te dalura nga lufta e UÇK-së, më të cilën vërtetohet se jam Veteran Invalid i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. I propozon gjykatës që paditësin ta liroi nga pagesa e takës gjyqësore për padi. Për këtë qëllim, gjykata pasi analizoi dhe vlerësoi shkresën, përkatësisht kërkesën e paditësit për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore për padi, gjeti se lirimi nga pagesa e taksës gjyqësore për padi nuk ka asnjë bazë ligjore sipas Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nr.01/2017, të datës 22.03.2017, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, si dhe Mendimit Juridik të dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës me nr.64/2016, të datës 18.02.2016 dhe se nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet e përcaktuara me nenin 468 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm konform nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative.”*

Kolegji i Gjykatës të Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktvendimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, vëren se aktvendimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika nën paragrafi n) dhe nenit 253 paragrafi 5 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, për çfarë është dashtë që ky aktvendim të priset.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, vëren se paditësit Gjykata e shkallës së parë ia ka dërguar vërejtjen për pagimin e taksës gjyqësore për padi në shumë prej 50€, në afatin prej 15 ditësh, nën kërcënimin e pasojave juridike. Pasi që gjykata ka konsideruar se paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes të gjykatës për pagesën e taksës gjyqësore për padi, atëherë Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me aktvendimin e atakuar ka vendosur, *“I.*

REFUZOHET kërkesa e paditësit e datës 19.06.2023 për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore për padi. II. KONSIDEROHET se është tërhequr padia e paditësit S.C me adresë në rr. "Merqezi" pa nr.-Komuna e Podujevës, nën shenjë A.nr.390/2023 i dt.22.02.2323, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore për padi."

Kolegji i apelit vlerëson se përfundimi i Gjykatës së shkallës së parë në aktvendimin e atakuar si dhe të gjitha shkresat e lëndës nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse i njëjti nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresat e lëndës.

Nga shkresat e lëndës në rastin konkret rezulton se pas dorëzimit të vërejtjes së gjykatës për pagesën e taksës gjyqësore, paditësi me datë;19.06.2023, ka ushtruar kërkesë në Gjykatë për lirim nga taksa gjyqësore, mirëpo Gjykata shkallës së parë ka nxjerrë aktvendim me të cilin përveç që ka refuzuar kërkesën për lirim nga taksa me të njëjtin aktvendim e ka konsideruar edhe të tërhequr padinë e paditësit, pa ia dhënë mundësinë paditësit që ta ankimoj në Gjykatën e shkallës së dytë aktvendimin për refuzimin e kërkesës për lirim nga taksa. Kurse një e drejtë e tillë nuk i është dhënë paditësit ashtu siç përcaktohet me nenin 206 paragrafi 1 të LPK-së, i cili përcakton se *"Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë lejohet ankimi, në qofte se në këtë ligj nuk është përcaktuar që ankimi nuk lejohet. 206.2 Po që se me këtë ligj parashihet shprehimisht se ankimi i veçantë nuk lejohet, aktvendimi i shkallës së parë mund të goditet vetëm me anë të ankesës që paraqitet kundër vendimit me të cilin përfundon procedimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë."*

Ndërsa kolegji i apelit vëren se pas analizimit të dispozitivit të aktvendimit kontestues gjykata e shkallës së parë ka vendosur për dy çështje në të njëjtën kohë, pa i dhënë mundësi paditësit që fillimisht të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit për refuzimin e kërkesës për pagesën e takës gjyqësore nga Gjykata e shkallës së dytë, dhe se vetëm pas konfirmimit të aktvendimit për refuzimin e lirim të taksës gjyqësore nga Gjykata e apelit, nëse eventualisht do ta kontestonte paditësi, atëherë Gjykata e shkallës së parë do të mund të vendoste për tërheqjen e padisë së paditësit për mos pagesë të taksës, por jo siç ka vepruar në rastin konkret. Ngase sipas vlerësimit të kolegjit të apelit për të dy këto çështje lejohet ankimi veçantë në Gjykatën e shkallës së dytë. Mbi këtë bazë aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë e bënë të pa bazë, e rrjedhimisht edhe të paqëndrueshëm.

Prandaj, kolegji i Gjykatës së Apelit, e aprovoi ankesën si të bazuar, ngase pretendimet e paditësit janë pretendime të bazuara në ligj. Andaj kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi ashtu që prishi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe çështjen e kthej në rishqyrtim dhe rivendosje, me të cilin gjykata e shkallës së parë fillimisht do të vendose për kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore, dhe pasi të përfundoj në tërësi procedura në raport me aktvendimin për kërkesën për lirim nga taksa, atëherë mund të vendosë për tërheqjen e padisë së paditësit në rast se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore për padi.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili zbatohet në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AA.nr.648/2023, datë;13.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti